

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË “RA ENERGY” SH.P.K**

Sot, më datë 01/06/2023 në Tiranë,

- **Rogert Huqi**, atësia Gëzim, amësia Shqipe, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, me adresë Don Bosko; Nd. 0; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 13/07/1978, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036477878 dhe nr. personal H80713148P
- **Almir Bodurri**, atësia Mestan, amësia Rakipe, shtetas Shqiptar, lindur në Gostimë, Elbasan dhe banues në DURRËS, me adresë Hysen Myshketa 00690344; Nd. 28; H. 1; Durrës; Durrës; 2004; Durrës, lindur më 12/04/1983, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035353702 dhe nr. personal I30412182A
- **Artiola Hoxha**, atësia Bujar, amësia Vasilika, shtetase Shqiptare, lindur në Permet, dhe banuese në Tirane, me adresë“ koferenca e Pezes”; Nd. 164; H. 25; Ap;32 Njesia Administrative nr 7 ,Njesia bashkiake nr 7;1023;Tirane lindur më 17/10/1987, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034309346 dhe nr. personal I76017054S.

Tecilet kanë vendosur themelimin e shoqërisë “Ra Energy” Sh.p.k, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria “Ra Energy” Sh.p.k., është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, (në vazhdim Shoqëria). Shoqëria është Person Juridik Privat dhe gëzon formën ligjore të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 2**

**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin; “Ra Energy” Sh.p.k

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:



Tregtim, implementimi, mirembajtje dhe menaxhimi i produkteve dhe projekteve gjeneruese te energjise elektrike solare (fotovoltaike) dhe energjise se eres (eolike) dhe cdo produkti tjetër ne lidhje me kete sektor, import-eksport, shitja me shumice e pakice e tyre dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministrive e Institucioneve te Shtetit Shqiptar i te gjitha miratimeve, lejeve dhe licensave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise, per qellime investimesh ne sektorin bujqesor/agrar/blegtori, ndertim me qellim komercial tregtar, residencial, etj. Dhenie me qera/nenqera pronash/ asete, menaxhim pronash, shitblerje real estate. Konsulence financiare, cdo lloj aktiviteti tjetër qe lejohet sipas legjislacionit Shqiptar Ofrimin e shërbimeve të konsulencës inxhinierike elektrike me specifike teknologjinë fotovoltaike, duke përfshirë por pa u limituar në: Import-eksport dhe tregtim të pajisjeve, makinerive, materialeve ose sistemeve të prodhimit dhe konservimit të energjise elektrike nga teknologjia e fotovoltaikeve dhe teknologjia e pajisjeve që i shërbejnë asaj, përfshirë por pa u limituar në: pajisje elektrike, elektronike ose elektromekanike që përmbajnë teknologji fotovoltaike, module fotovoltaike, invertera fuqie (invertera diellorë), kontrollorë karikimi, pajisje montimi të sistemeve fotovoltaike përfshirë sistemet ndjekës, bateri, kabëll solar, pajisje mbrojtëse, aksesore, elektropompa fotovoltaike, matësa me dy drejtime (bidireksionale) dhe sisteme të monitorimit në distancë ose grumbullimit të të dhënave nga sistemeve fotovoltaike, përfshirë edhe software. Zhvillimin, Projektimin, Studimin e Fizibilitetit. Hartimin e projekteve elektrike fotovoltaike. Vizatimet inxhinierike dhe specifitime teknike për impiante fotovoltaike , për impiante kogjeneruese që përfshijnë teknologjinë fotovoltaike, për sisteme fotovoltaike te lidhur ne rrjet, dhe autonom si dhe ato Hibride në objekte rezidenciale, tregëtare, institucione, terrene dhe në çdo objekt tjetër për të cilin do të arrihet mareveshja. Sigurimin e shërbimeve të implementimit, ndërtimit, kolaudimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së impianteve (ose centraleve FV) të impianteve kogjeneruese që përmbajnë teknologjinë fotovoltaike dhe, të çdo sistemi ose pajisjeje tjetër që përmban teknologjinë fotovoltaike. Ofrimin e shërbimeve të optimizimit të sistemeve FV, të projektimit dhe implementimit të zgjerimit të sistemeve FV ekzistuese, të integritimit të sistemeve që përmbajnë teknologjinë fotovoltaike, të monitorimit të sistemeve fotovoltaike. Kryerjen e punimeve civile në funksion të ndërtimit të impianteve FV të lartpërmendura. Kryerjen e testimeve, shërbimeve të matjeve të natyrës elektrike dhe matjeve meteorologjike në funksion të projektimit dhe monitorimit të sistemeve FV. Ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të çdo projekti që përfshin teknologjinë fotovoltaike. Objekt i kësaj Shoqërie do të jetë dhe çdo veprimtari tjetër ligjore tregëtare lidhur me sa më lart, konform legjislacionit në fuqi. Implementimin dhe zbatimin e projekteve per eficencen energjitike konform legjislacionit ne fuqi.

Instalime elektrike.

Ndertimi, Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave te tyre ndihmese. Përfshire dhe pa u kushtezuar vetem ne marrjen e te gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet pergjegjese Shteterore (qofshin keto organe Qendrore apo Vendore), apo private te cilat mundesojne zhvillimin e ketyre aktiviteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

#### NENI 4 Selia e Shoqërisë



Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Bulevardi Taulantia, Rr"HYSEN MYSHKETA" 00690344; Nd. 28; H. 1; DURRËS; 2004; DURRËS, dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqesimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

#### NENI 5

##### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues në vlerën 1.000,00 (njëmijë) lekë i ndarë në 3 (tre) kuota. Ortaket themelues të shoqërisë tregtare "RA ENERGY" SH.P.K., zotërojnë kuotat në shoqëri si në vijim:

- **Rogert Huqi** zoterues i 25% të kuotave të kapitalit, me vlerë 250 leke, e ndare në 1 (nje) kuote.
- **Almir Bodurri**, zoterues i 50% të kuotave të kapitalit, me vlerë 500 leke, e ndare në 1 (nje) kuote.
- **Artiola Hoxha**, zoteruese e 25% të kuotave të kapitalit, me vlerë 250 leke, e ndare në 1(nje) kuote.

Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

#### NENI 6

##### Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

#### NENI 7

##### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetëm i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtëritshëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Shoqëria për çdo rast mund të zgjedhë edhe me shumë se një Administrator.

- Administratore e Shoqërisë "RA ENERGY " Sh.p.k. do të jete **Znj Artiola Hoxha**, atësia Bujar, amësia Vasilika, shtetase Shqiptare, lindur në Permet, dhe banuese në Tiranë, me adresë "koferenca e Pezes"; Nd. 164; H. 25; Ap;32 Njesia Administrative nr 7 ,Njesia bashkiake nr 7; 1023 ; Tiranë lindur më 17/10/1987, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034309346 dhe nr. personal I76017054S.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

##### **Organizimi dhe funksionimi**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

#### **NENI 9**

##### **Pergjegjesite**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 10**

##### **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 11**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**


Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


#### **NENI 12**

##### **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

#### **ORTAKET THEMELUES**

  
Rogert Huqi

  
Almir Bodurri

  
Artiola Hoxha